UDHËZIM
Nr. 1289/1, datë 4.5.2021

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT TË MJETEVE LUNDRUESE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, "Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë", të nenit 24, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 462, datë 9.7.2014, "Për miratimin e rregullores 'Për regjistrimin e mjeteve lundruese", ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare të jenë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Të ardhurat, që realizohen nga shërbimet të derdhen në llogarinë e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, sipas ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, "Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë".
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare për zbatimin e këtij udhëzimi.

Të gjitha aktet që bien në kundërshtim me këtë udhëzim shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Lidhja nr. 1

EMËRTIMI I SHËRBIMIT	TARIFA, LEK	SEKTORI QË I LËSHON
Tarifë e certifikatës së regjistrimit	10000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Regjistrim mjeti pa motor	1500	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Regjistrim mjeti me motor	6500	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Leje lundrimi	3500	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Dëshmi kualifikimi për peshkatarët	900	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Dëshmi kualifikimi për detarët (STCW-78/95)	1600	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Ndryshimi i pronësisë së mjetit	2000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve

Zgjatje afti i lejes së lundrimit	5000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Çregjistrimi i mjeteve detare pa motor	500	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Çregjistrimi i mjeteve detare me motor me aftësi lundrimi deri 6 milje nga bregu	2000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Çregjistrimi i mjeteve detare me aftësi lundrimi mbi 6 milje nga bregu	5000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Pranimi i protestave detare	5000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Lëshimi i certifikatës minimumit	1000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve